



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Nr. _____ prot.

Elbasan ____ .09.2026

Lënda: Dërgim njoftimi për shpallje konkursi për vend të lirë pune.

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORISË SË PUBLIKIMIT TË NJOFTIMEVE
TIRANË**

Bashkëngjitur gjeni njoftimin për shpallje konkursi për pozicion pune, personel ndihmës akademik me karakter administrativ, me kohë të plotë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

REKTORI

Prof.dr.Elvira Fetahu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Fakulteti i Shkencave të Natyrës, së Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel ndihmësakademik me karakter administrativ, Përgjegjës i Labororit Eksperimental.

Përgjegjësi i Labororit Eksperimental: është personel ndihmësakademik me karakter administrativ, i cili përgjigjet për organizimin, administrimin dhe funksionimin e labororit, garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive laboratorike, mirëmbajtjen dhe administrimin e pajisjeve dhe materialeve laboratorike si dhe respektimin e rregullave të sigurisë në laborator. Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) në lidhje me aktivitetet e vlerësimit, akreditimit, mbikqyrjes dhe rivlerësimit. Bashkëpunon me specialistët e sektorit, Dekanin dhe të tretë si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë e pozicionit. Raporton te Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës në lidhje me veprimtarinë e labororit.

Kandidati/a duhet të plotësojnë kritere të përgjithshme e të posaçme, për këtë pozicion pune, si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar dhe të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim ë formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Të plotësojë kriteret e posaçme.

Kritere të posaçme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë Master i Shkencave ose ekuivalente me të, në Kimi Industriale dhe Mjedisit/ Inxhinieri Kimike. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësuara nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- Të ketë jo më pak se 3 (tri) vite përvojë pune në laborator;
- Të ketë njohuri dhe përvojë në përdorimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e pajisjeve dhe instrumenteve laboratorike;
- Të ketë njohuri dhe përvojë në përgatitjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit teknik dhe të cilësisë së labororit;
- Të ketë njohuri mbi rregullat e sigurisë dhe procedurat e punës në laborator;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Të ketë kualifikime dhe/ose trajnime profesionale brenda dhe jashtë vendit, të vërtetuara me dokumentacion në fushat përkatëse;
- Të ketë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj, të vërtetuar me dokumentacion;
- Të ketë njohuri mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe kërkesat e akreditimit të laboratorëve;
- Të ketë aftësi të mira, organizative, menaxhuese dhe komunikuese e të punës në grup dhe për të bashkëpunuar me strukturat drejtuese, personelin akademik dhe palë të treta.

Kandidatët duhet të dorëzojnë **në rrugë postare**, për periudhën **28.09.2026 – 07.10.2026**, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular aplikimi (gjendet në www.edu.al);
- Jetëshkrim i detajuar;
- Kopje të diplomave, listës së notave dhe certifikatave të noterizuara. Diplomat e lëshuar nga institucionet e huaja, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga ministra përgjegjëse për arsimin;
- Dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve, publikimeve ose veprimtarive profesionale, sipas kriterëve të shpallura;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, jo më e vjetër se 3- muaj nga data e aplikimit;
- Raport i aftësinë për punë, jo më e vjetër se 3- muaj nga data e aplikimit;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Certifikatë personale dhe familjare
- Çdo dokument që përmbush kriteret e përcaktuara në shpalljen e konkursit.

Të interesuarit duhet të dërgojnë dokumentacionin **në rrugë postare**, brenda periudhës **28.09.2026 – 07.10.2026**, në adresën si më poshtë:

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

APLIKIM PËR POZICIONIN E PUNËS: Përgjegjës i Labororit Ekperimental

KATEGORIA: Personel ndihmës akademik.

DATA E DORËZIMIT: _____.____.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Komisioni ad-hoc do të verifikojë dhe vlerësojë paraprakisht dokumentacionin. Kandidatët që plotësojnë kriteret e shpallura, kalojnë në fazën e intervistës. Konkursi do të zhvillohet për periudhën 12.10.2026 – 30.10.2026. Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit dhe më pas shpalljen /njoftimin e fituesit.